



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01 - Nr. 05-400-27763.
Kaçanik; 30.10.2012.

Në mbështetje të neneve 13, 17 dhe 58. të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të neneve 17 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, të Ndryshuara me Ligjin nr.03/L-221, të neneve 2, 7, 8 dhe 22. të Ligjit nr.03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 73. të Statutit të Komunës së Kaçaniku, Kryetari i Komunës mori këtë

V E N D I M
PËR SHUMËN MAKSIMALE TË ARKËTIMIT TË TË HYRAVE NËPËR
TREZORËT E ARKËS

1. Me këtë vendim u lejohej të gjithë programeve buxhetore të cilat bëjnë arkëtimin e drejtpërdrejt të të hyrave, që në trezorët e tyre mundë të arkëtojnë drejtpërdrejt shumën maksimale deri në **10,00 €** / me germa: dhjetë euro /.
3. Pagesat e të hyrave mbi shumën e kufizuar sipas pikës 1. të këtij vendimi, të gjithë taksapaguesit janë të obliguar që të bëjnë pagesat vetëm përmes bankave komerciale duke i depozituar drejtpërdrejt në llogarinë bankare të Buxhetit të komunës: **1000650120000030.**
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, të cilës duhet të gjithë zyrtarët e autorizuar për arkëtimet e pagesave në të gatshme, t'i ofrojnë së paku në çdo fundjavë raport dhe specifikacion të arkëtimeve të realizuar për të gjitha të hyrat sipas llojit të burimit.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi duke filluar nga data 01.11. 2012, shfuqizohet vendimi i deritanishëm 01-Nr.04-86/2008, i datës 06.02.2008.

Besim Ilazi,
Kryetar i Komunës

Ky vendim iu dërgohet:

1. Drejtorisë Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit,
2. Të gjithë trezorëve/arkëtarëve të autorizuar në OB, dhe
3. Arkivi.